

**Raport për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis për Impiantin e
Therjes së Gjedheve në fshatin Zallç, Komuna e Istogut (Zona
Kadastrale Zallç, P-70806017-00521-25)**

Sylë A. Shala B.I.

**RAPORT PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS PËR
IMPIANTIN E THERJES SË GJEDHEVE NË FSHATIN ZALLÇ,
KOMUNA E ISTOGUT (ZONA KADASTRALE ZALLÇ,
NR. P-70806017-00521-25)**

Aplikuesi& Investitori:
Sylë A. Shala B.I.
Pronar: Sylë Shala
Adresa: Rruga Ibrahim Rugova, Nr 34 Istog
Tel:
E-mail:

Aplikuesi:

Sylë A. Shala B.I.

Shtator, 2025

HARTUESIT E RAPORTIT:

Dr.sc. Astrit Shala

Email: astrit-shala@hotmail.com

Tel: 044800098

Adresa: Prishtinë

Shtator, 2025

Përmbatja:

1.	Hyrje	6
2.	BAZA LIGJORE PËR HARTIMIN E RAPORTIT	7
2.1.	Metodologjia e punës	8
3.	PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT	9
3.1.	Potencialet ekzistuese	9
3.2.	Pozita gjeografike e lokacionit	10
3.3	Popullata dhe Vendbanimet.....	11
3.4	Infrastruktura ekzistuese	12
3.5	Kushtet klimatike	12
3.6	Gjendja Hidrologjike	13
3.7	Flora dhe Fauna	16
3.8	Ndërtimi gjeologjik i lokacionit.....	16
3.8.1	Depozitimet e Neogjenit.....	16
3.8.2.	Depozitimet e Kuaternarit.....	17
3.9.	Karakteristikat sizmike	17
3.10.	Efektet vizuale (peizazhi).....	18
3.11.	Ajri	18
3.12.	Uji	18
3.13.	Zhurma	18
3.14.	Natyra dhe biodiversiteti	18
4.	PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE INFRASTRUKTURA	20
4.1.	Objektivat dhe infrastruktura.....	20
4.2.	Procesi teknologjik i therjes se gjedheve per nevoja te restorantit	21

4.6. Procesi qe zhvillohet ne thertore	22
4.6.1. Korridori i transportit të kafshëve dhe vendi për mbajtjen e kafshëve para therjes	22
4.6.2. Hapësira për therjen e gjedheve	23
4.6.3. Hapësira për organet abdominale	25
4.6.4. Burimi i gjedheve dhe kapaciteti aktual i therjes	26
5. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS	28
5.1. Ndikimet në ajër	28
5.2. Ndikimet në tokë	29
5.3. Ndikimet në ujë	29
5.4. Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë	30
5.5. Ndikimet në vendbanime dhe popullatë	30
5.6. Ndikimet nga zhurma	30
5.7. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore	31
6. MASAT E MBROJTJES SË MJEDISIT	32
6.1. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër	32
6.2. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë dhe në tokë	32
6.3. Masat për mbrojtje nga zhurma	34
6.4. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë	34
6.5. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë	34
6.6. Masat për mbrojtje nga rreziqet dhe aksidentet mjedisore	34
7.7. Menaxhimi i mbeturinave	36
7. MONITORIMI DHE RAPORTIMI	37
7.1. Monitorimi	37
7.2. Raportimi	37

8.	MASAT REHABILITUESE PAS PËRFUNDIMIT TË AKTIVITETIT	38
9.	KONKLUSIONE	39
10.	Literatura	40

Lista e Figurave:

Figure 1.	Raportet themelore ndërmjet faktorëve natyrorë dhe potencialeve ekologjike	9
Figure 2.	Lokacioni është në fshatin Zallc, Istog	11
Figure 3.	Lokacioni i impiantit dhe distanca me objektet banimi&industrial.	12
Figure 4.	Distanca ne mes te Lumit dhe Therretores.	15
Figure 5.	Objekti ku zhvillohet aktiviteti I therrëtorës.	21
Figure 6.	Skema e procesit teknologjik.	22
Figure 7.	Vendi ku vendosen gjedhet para therrjes.	23
Figure 8.	Hapesira për therrjen e gjedheve.	24
Figure 9.	Vendosja e gjedheve per therrje.	25
Figure 10.	Hapësira për organet abdominale.	26
Figure 11.	Gropa septike per trajtim primar.....	33

1. Hyrje

Nevoja për mish të freskët gjithmonë janë mjaft të mëdha pasi që edhe kërkesa për konsumit të mishit janë të mëdha, prandaj njëkohësisht është edhe mjaft profitabil, për këtë arsye pronari i biznesit individual Sylë Shala, në lokacion Zallc – Istog, kanë hapur këtë thertore për të therur gjedhe për nevojat e konsumatorit.

Ky Raport i vlerësimit të ndikimit në mjedis është përgatitur për impiantin e regjistruar si Biznesi Individual në emër të Sylë Shala, dhe trajton ndërtimin e fabrikës së therrjes së gjedheve, me infrastrukturë përcjellëse. Raporti është hartuar në bazë të legjislacionit mjedisor të Republikës së Kosovës, në veçanti Ligjit Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

Për këtë qëllim Investitori ka iniciuar hartimin e raportit të VNM-së për të identifikuar ndikimet e mundshme në mjedis, me qëllim të ndërmarrjes së masave të nevojshme për minimizimin e ndikimeve negative të mundshme në mjedis.

Tereni ku është ndërtuar objekti është i rrafshët dhe hapësira-lokaliteti respektivisht zona (zona e ngushtë) ku është realizuar projekti nuk i takon ndonjë zonë të mbrojtur të natyrës dhe në këtë zonë nuk ka ndonjë specie që është në rrezik për zhdukje, apo ndonjë zonë me rëndësi historike ose kulturore e cila do të mund të ndikohet me rastin e zhvillimeve të planifikuara lidhur me veprimtarinë e lartë përmendur.

Raporti përshkruan gjendjen e përgjithshme në dhe rreth lokacionit të projektit, kushtet mjedisore ekzistuese, përshkrimin teknik të projektit që është realizuar, ndikimet e mundshme të projektit në mjedis, si dhe masat për parandalimin apo minimizimin e ndikimeve në mjedis.

Identifikimi i ndikimeve potenciale në mjedis, identifikimi i masave për zbutjen e këtyre ndikimeve si dhe ndërmarrja e masave adekuate për të ndikuar në evitimin apo minimizimin e ndikimeve të këtij projekti në mjedis, janë komponentët kryesorë të këtij raporti. Në terren janë realizuar vizita në lokacionin e projektit, janë bërë matjet e nevojshme të lokacionit me GPS, është incizuar gjendja e terrenit dhe janë bërë fotografi për lehtësimin e përgatitjes së këtij raporti. Raporti është punuar në bashkëpunim të ngushtë me investitorin, prej të cilit janë marrë të dhënat kryesore dhe të nevojshme përmes bisedave.

Raporti është hartuar në bazë të informatave të siguruar nga Web faqja e K. Istogit, nga literatura ekzistuese për zonën. Për hartimin e këtij raporti janë përdorur të dhëna nga përshkrimi teknik i projektit si dhe të dhëna dhe materiale relevante për projekte të ngjashme.

Ngritja respektivisht zhvillimi i kësaj veprimtarie pa dyshim se do të ndikon pozitivisht në të mirë të krijimit të prodhimeve vendore si dhe në aspektin socio-ekonomik përmes krijimit të vendeve të reja të punës.

2. BAZA LIGJORE PËR HARTIMIN E RAPORTIT

Para se të fillojmë në përpilimin apo studimin e një zone që i nënshtrohet procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis është me rëndësi të shqyrtohen ligjet për mbrojtjen e mjedisit.

Bazuar në karakteristikat e impiantit me infrastrukturë përcjellëse dhe sipas projektit (vendndodhja, madhësia e shtrirjes, ndikimet e mundshme në mjedis etj.), ky projekt që është planifikuar të ndërtohet është subjekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis. Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis i cili është baza kryesore ligjore të cilit ju kemi referuar.

Ligjet më të rëndësishme të aplikuara për hartimin e VNM-së për projektin për projektet e tilla janë si me poshtë:

- Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis
- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji për mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 08/L-025
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060
- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233
- Ligji për Mbrojtje nga Zhurma Nr. 02/L-102
- Ligji për Ndërtim Nr. 04/L-110,
- Ligji nr. 04/L-012 për mbrojtje nga Zjarri,
- Ligji për Tokën Bujqësore Nr. 02/L- 26
- Ligji Nr. 08/L-112 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Tokën Bujqësore Nr. 02/L-26
- Ligji për Ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji për Rrugë Nr. 2003/11
- Ligji Nr. 06/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugë Nr. 2003/11 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 03/L-120
- Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060 - shtojca
- Ligji Nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Mbeturina Nr. 04/L-060
- Ligji Nr. 08/L-176 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedurat të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me ligjin Nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative
- Udhëzimi Administrativ për vlerat kufizuese të efluentit që shkarkohet në trup ujqor dhe në rrjetin e kanalizimit publik.

- Udhëzim Administrativ nr. 13/2013 për katalogun shtetëror të mbeturinave.

Pasi që për këtë veprimtari është e nevojshme të bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM), atëherë për të adresuar ndikimet mjedisore të mundshme, masat për zvogëlimin e ndikimeve dhe përputhshmërinë ligjore, investitori ka vendosur që të kryej një studim përkatës të vlerësimit të ndikimit në mjedis, të përgatis raportin dhe të aplikojë për pëlqim mjedisor në Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukture (MMPHI).

2.1. Metodologjia e punës

Për të vlerësuar ndikimin në mjedis (VNM) si dhe për të identifikuar masat për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në mjedis, për thertoren në rrugën regjionale Klinë-Istog, është ndjekur qasja e vlerësimit të përgjithshëm të projekteve të kësaj natyre, si dhe është bërë analiza dhe identifikimi i ndikimeve të mundshme sipas fazave.

Informatat themelore mbi:

- Burimet themelore të ndikimeve në mjedis,
- Popullatën dhe vendbanimet në lokacion,
- Karakteristikat hidrologjike, topografia dhe peizazhi në lokacionin e projektit,
- Klima dhe të dhënat meteorologjike,
- Kualiteti i ajrit, ujit dhe komponentëve tjerë mjedisor në lokacion,
- Bota bimore dhe shtazore në lokacionin e projektit.

Vlerësimi i ndikimeve sipas kriterëve në vijim:

- Gjendja e mjedisit në lokacionin e projektit,
- Lloji dhe madhësia e pritshme e ndotjes nga projekti,
- Karakteristikat dhe përbërja e materialit ndotës,
- Vlerësimi i përhapjes së ndotjes.

Përcaktimi i masave për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në mjedis, duke u bazuar në rezultatet / të gjeturat nga vlerësimi i ndikimeve në mjedis, në lokacionin e projektit.

3. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT

Karakteristikat themelore të gjendjes ekzistuese të lokacionit janë bazë themelore për hartimin e Raportit.

Hulumtimi dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese është bërë duke i shfrytëzuar hulumtimet studimore të bëra në këtë terren. Për t'u definuar gjendja ekzistuese në mënyrë të kënaqshme dhe për t'u krijuar një bazë reale për hulumtim të ndikimeve të mundshme, në kuadër të gjendjes ekzistuese janë prezantuar edhe të dhënat relevante që kanë të bëjnë me të dhënat ekzistuese morfologjike, gjeologjike, hidrologjike, hidrografike dhe meteorologjike.

Rëndësia e veçantë e këtij projekti është, pos tjerash, në zhvillimin e ekonomisë komunale të Istogut. Një ndër prioritetet në realizimin e këtij projekti është krijimi i vendeve të reja të punës dhe furnizimi me mish të freskët i komunës së Istogut dhe rrethines.

3.1. Potencialet ekzistuese

Njëri nga elementet kyç të hulumtimi i gjendjes ekzistuese të mjedisit është hulumtimi i potencialit ekzistues, e që konsiston në analizën e mirëfilltë të tërësisë hapësinore në zonën më të gjërë të lokacionit, me qëllim që në bazë të pasojave të njohura të vlerësohen mundësitë e rrezikut ekologjik dhe në bazë të tyre të rekomandohen masat për zvogëlimin ose edhe eliminimin e tyre.

Karakteristikat e potencialit ekologjik përbëhen nga kombinimi i ndikimeve të ndërsjella të faktorëve natyror si që janë toka, uji, ajri, reliefi, flora dhe fauna.




Figure 1. Raportet themelore ndërmjet faktorëve natyrorë dhe potencialeve ekologjike.

Çdonjëri nga potencialet ekologjike në këtë mënyrë posedon funksione të caktuara, që në esencë kanë rëndësi të dorës së parë analizën e problematikës së tërësishme të mbrojtjes së

mjedisit. Ndikimi i ndërsjellë i faktorëve të veçantë si dhe ndikimi i tyre në formimin e potencialit ekologjik dhe i funksioneve të tyre themelore me interes për analizën në fjalë, së bashku me kompleksin e marrëdhënieve të mundshme është paraqitur në figurën nr.1. Në bazë të raporteve të paraqitura në figurën 1. është e qartë që faktorët natyror formojnë disa potenciale natyrore karakteristikat funksionale të të cilave duhen marrë parasysh gjatë valorizimit të ndikimit në mjedis të parkut të energjisë diellore të planifikuar të ndërtohet në hapësirën konkrete.

3.2. Pozita gjeografike e lokacionit

Komuna e Istogut shtrihet në pjesën veriore të rrafshit të Dukagjinit. Komuna, në veri-perëndim kufizohet me Malin e Zi dhe Serbinë, në veri-lindje me komunën e Zubin Potokut, në lindje me komunën e Skenderajt, në jug me komunën e Klinës dhe në jug-perëndim me komunën e Pejës. Qendër komunale është qyteti Istog. Komuna ka 50 vendbanime prej të cilave 1 është qytet-Istogu, 1 vendbanim është qytezë-Gjurakoci dhe tjera vendbanime janë fshatra: Baja, Bajica, Llukavci i Begut, Belica, Bollopoja, Veriqi, Vrella, Orroberda, Dobrusha, Istogu i Poshtëm, Dragolevci, Dreja, Dubrava, Zhakova, Zallçi, Zabllaqi, Kalijani, Kashica, Kovraga, Koshi, Kërnina, Llugat, Lubova, Lubozhda, Dubova e Vogël, Mojstiri, Muzhevina, Veriqi i Ri, Osojani, Polana, Prekalla, Prigoda, Rakoshi, Syneja, Serbobrani Saradrani, Cërkolezi, Sudenica, Llukavci i Thatë, Suhogërlla, Shushica, Tomoci, Trubuhoci, Tuqepi, Uça, Corolluka, Cërrca dhe Shalinovica.



Figure 2. Lokacioni është në fshatin Zallc, Istog

Ngastra ku ndodhet thertorja për gjedhe është ne Zallc te Istogut dhe ka këtë numër te kadastrës P-70806017-00521-25.

3.3 Popullata dhe Vendbanimet

Njërën nga veçoritë qenësore të hapësirës së analizuar, në kuptim të përcaktimit të ndikimeve të mundshme në mjedis, e paraqet popullata dhe demografia e saj. Këto fakte kuptimin e plotë të tyre e kanë në hulumtimin e hollësishëm të ndikimeve të mundshme negative në banorë që jetojnë në hapësirën e analizuar.

Në afërsi të drejtpërdrejtë me lokacionin ku zhvillohet kjo veprimtari ekonomike, janë të pranishme disa objekte banimi, të cilat ndodhen në një distancë prej afërsisht 10 metrash nga kufiri i parcelës. Duke pasur parasysh këtë afërsi të ndjeshme, investitori ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që aktiviteti i tij të mos ketë ndikim negativ në cilësinë e jetesës së banorëve përreth. Këto masa përfshijnë ndërtimin e barrierave fizike mbrojtëse, implementimin e teknologjive për reduktimin e zhurmës dhe pluhurit, si dhe respektimin rigoroz të standardeve mjedisore dhe urbanistike në fuqi. Gjithashtu, janë paraparë masa shtesë për monitorimin e vazhdueshëm të ndikimeve potenciale, me qëllim që të garantohet ruajtja e sigurisë dhe mirëqenies së komunitetit përreth.



Figure 3. Lokacioni i impiantit dhe distanca me objektet banimi&industrial.

3.4 Infrastruktura ekzistuese

Sa i përket infrastrukturës ekzistuese, lokacioni është në afërsi të drejtpërdrejt me rrugën e ktiye fshati. Përgjatë rrugës janë të zhvilluara edhe rrjetet infrastrukturore, të cilat objekti mund ti shfrytëzoj sipas nevojës me pëlqime paraprake nga institucionet kompetente shtetërore. Infrastruktura e zhvilluar nuk do të rrezikohet nga aktiviteti, sepse nga ana e investitorit do të respektohen të gjitha kriteret dhe procedurat mbizotëruese.

3.5 Kushtet klimatike

Territori ku do të ndërtohet impianti në Komuna Istog, kryesisht ka klimë kontinentale dhe mediterane të modifikuar që karakterizohet me vera të nxehta dhe dimra të ftohtë e të pasur me reshje sidomos gjatë vjeshtës, dimrit dhe pranverës së hershme. Reshjet janë të pranishme sidomos gjatë vjeshtës, dimrit dhe pranverës, dhe ato janë të formës së ndryshme (shi, borë, breshër) me karakter të gjerë gjatë dimrit ose me karakter lokal gjatë pranverës dhe verës. Gjatë periudhës vegjetative sasia e të reshurave në Bellopojë është rreth 60 mm. Reshje me se shumti ka në nëntor (113 mm) dhe dhjetor (107 mm) ndërsa me së paku ka në gusht vetëm 44.3 mm.

Temperatura mesatare sillet prej 11.2°C gjer në 11,9°C. Temperaturat më të larta janë regjistruar në muajin korrik dhe gusht ku shpesh mund të arrin deri në 39°C. Temperaturat minimale vjetore mund të arri deri -29°C. Mesatarja vjetore për Pejë është 11.1 °C. Në përgjithësi muaj të nxehtë dhe të thatë janë muajt korrik, gusht dhe shtator.

Në komunën e Istogut erërat më të shpeshta janë ato që vijnë nga veriu dhe ato nga jugu që shpesh mund të zhvillojnë shpejtësi të caktuar.

3.6 Gjendja Hidrologjike

Komuna e Istogut ka rrjet mjaft të zhvilluar hidrografik, gjegjësisht ka numër mjaft të madh të lumenjve (përroskave) që kalojnë në territorin e saj.

Lumenjtë e vegjël janë lumenj me tipare karakteristike për përroskat malore, që do të thotë se janë lumenj të vegjël, me oscilime shumë të mëdha të sasisë së ujit gjatë vitit. Gjatë thatësirave, në shumicën e këtyre lumenjve ka shumë pak ujë ose nuk ka ujë fare, kurse gjatë kohës me reshje shpesh ndodh që të ketë vërshime lokale.

Lumenjtë dhe Burimet - Lumenjtë kryesor në komunën e Istogut janë: lumi i Istogut, lumi i Vrellës dhe Drini i Bardhë, ndërsa rrjedha tjera ujore me rëndësi janë edhe: Shushica, Përroi i keq, Çausi, Gujavçi, Bllagaça dhe lumi i Renovcit.

Lumi i Istogut është arteria kryesore hidrografike. Ky lum e ka burimin e vet nga ujërat nëntokësore të Moknës. Istogu është një ndër degët e majta të lumit më të madh në Kosovë, Drinit të Bardhë. Sipërfaqja e pellgut të Istogut është $F=434.7 \text{ km}^2$, kurse gjatësia e lumit është $L=14.0 \text{ km}$. Lumi Istog kalon nëpër qytetin e Istogut. Mbi gjysma e sipërfaqes së pellgut janë toka punuese dhe livadhe e kullosa, mirëpo ka edhe shumë sipërfaqe me djerrina, 10% male etj.

Nga burimi i lumit të Istogut, që ndodhet në afërsi të qytetit të Istogut, rrjedhin $3.0 \text{ m}^3/\text{sec}$ ose $(75-126) \cdot 106 \text{ m}^3$. Uji i këtij burimi shfrytëzohet për qëllimet në vijim:

- Për pije
- Për ujitje
- Për ekonomi peshku
- Për prodhimin e energjisë elektrike

Uji nga burimi merret nga dy krahët e tij. Në krahun e majtë merren $Q=0,8 \text{ m}^3/\text{s}$ për ujitje, kurse në anën e djathtë merren $2.86 \text{ m}^3/\text{s}$. Kjo sasi e ujit përdoret për tri qëllime: sasia prej $0.86 \text{ m}^3/\text{s}$ shfrytëzohet për ujë të pijes gjatë gjithë vitit, sasia prej $2.0 \text{ m}^3/\text{s}$ shfrytëzohet për ujitje gjatë muajve qershor-shtator, kurse gjatë muajve tjerë të vitit shfrytëzohet për prodhimin e energjisë elektrike. Pas daljes së ujit nga HEC-i, përmes kanalit të posaçëm dërgohet në rezervatin e rritjes së peshkut.

Lumi i Istogut është i pasur me ujë dhe siguron sasi të konsiderueshme të ujit për ujitjen e sipërfaqeve të punuara, pastaj për hurdhën e peshqve, hidrocentralin në Istog, si dhe për ujësjellësin e Istogut dhe të Gjurakocit.

Rrjedha mesatare vjetore e lumit të Istogut është afro 148.21×10^6 m³ ujë. Dy burime të fuqishme janë të kaptuara dhe ujërat e tyre sot shfrytëzohen për ujë për pije dhe për ujitje. Burimi i Istogut ka prej 1.4-4.5 m³/sec ujë dhe furnizimi i Istogut dhe Gjurakocit me ujë nga kaptazha bëhet me anë të ujëpërçuesve të veçantë $Q=50$ l/sec.

Lumi i Vrellës shfrytëzohet për furnizimin me ujë të vendbanimit të Vrellës, pastaj edhe për ujitjen e tokave të saj si dhe të fshatrave të afërta. Deri në ndërtimin e ujësjellësit Radavc-Banjë, uji i burimit të Vrellës është shfrytëzuar për furnizimin me ujë të pijshëm të banorëve të Banjës.

Burimi i Vrellës ka prej 0.17-2.0 m³/sec, i cili është kaptuar dhe që kryesisht eksploatohet për ujitje, ndërsa një pjesë e vogël përdoret për furnizimin me ujë të fshatrave përreth.

Drini i Bardhë më gjithë kapacitetin e tij shërben për ujësjellësin Radavc-Banjë, shfrytëzohet për ujitjen e tokave në territorin e komunës së Istogut, krahas me një pjesë të territorit të komunës së Pejës. Drini i Bardhë është kufiri natyral në mes të komunave Istog dhe Pejë.

UJËRAT NËNTOKËSORE

Ujërat nëntokësore të lumenjve janë ujëra burimorë potencial për shfrytëzim, sidomos për nevoja të ujitjes së sipërfaqeve bujqësore. Sipas shtrirjes së lumenjve të këtij territori, me pasuritë e tyre me ujë prej 3-10m dhe koeficient të porozitetit prej 20%, fitohen rezerva të ujit në aluvijolin e lumit të Istogut me afro 37×10^6 m³/vit.

Ujërat nëntokësore nuk shfrytëzohen për furnizim të ujësjellësit, por shfrytëzohen për pije nga pusët (bunarët) familjare. Këto ujëra janë të ndotura në mënyrë indirekte nga përdorimi i plehrave minerale dhe pesticideve, por në një masë të vogël. Ujërat nëntokësore më së tepërmi ndoten nga derdhjet e ujërave të zeza.

UJËRAT TERMO-MINERALE

Banja, e cila gjendet 15 km në pjesën perëndimore të Istogut, në vendin ku gjenden shpatijet e fundit të Moknës dhe Zhlebit, të cilat shkrihen në Rrafshin e Dukagjinit, është e njohur

me burimet e ujërave të nxehta. Temperatura e ujit e burimeve të nxehta është 46-48 °C, kurse sasia e përgjithshme e ujërave të tyre është 17,5 l/sec. Për nga cilësitë e tyre, hyjnë në radhën e ujërave tokësore-alkale, karbo-të tharta dhe me përmbajtje të vogël të sulfurit. Mjekojnë reumatizmin, ishiasin, sëmundjet e lëkurës, sëmundjet e eshtrave dhe nervave, si dhe sëmundjet kronike të femrave. Përveç ujit mineral të nxehtë, ekzistojnë edhe dy burime të vogla të ujit mineral të ftohtë. Këto nuk janë të rregulluara, por duhet t'u kushtohet rëndësi në të ardhmen, meqenëse ekzistojnë indikacione për mundësinë e përdorimit të këtij uji për qëllime mjekuese.

Lidhur me pozicionin gjeografik të lokacionin e therrëtorës, është e rëndësishme të theksohet se distanca ndërmjet këtij lokacioni dhe Lumit të Burimit është mbi 300 metra. Kjo distancë konsiderohet e mjaftueshme për të shmangur çdo ndikim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në cilësinë e ujërave të lumit. Për më tepër, investitori ka ndërmarrë të gjitha masat teknike dhe mbrojtëse të nevojshme për të garantuar se operimi i therrëtorës nuk do të ketë ndikim negativ në trupin ujqor përreth. Këto masa përfshijnë menaxhimin e kontrolluar të ujërave të ndotura, sistemin e trajtimit të mbetjeve dhe respektimin e distancave të përcaktuara sipas standardeve ligjore dhe rekomandimeve mjedisore.

Në këtë kontekst, referojuni hartës më poshtë për të parë paraqitjen vizuale të lokacionit në raport me rrjedhën e Lumit të Burimit dhe distancën mbrojtëse të respektuar.



Figure 4. Distanca ne mes te Lumit dhe Therretores.

3.7 Flora dhe Fauna

Analiza e gjendjes ekzistuese të florës në zonën ku është duke funksionuar kjo veprimtari tregon se deri më tani nuk janë kryer studime të detajuara dhe të thelluara shkencore që do të mundësonin nxjerrjen e përfundimeve të plota dhe të besueshme mbi biodiversitetin bimor të saj. Megjithatë, në bazë të vëzhgimeve vizuale të kryera në terren, është konstatuar se bimësia përreth karakterizohet kryesisht nga barishte të ulëta, kultura bujqësore sezonale, si dhe disa lloje bimësie të përzier. Në zonën më të gjerë përreth, flora dominohet nga drurë si bagremi dhe bungu, por janë të pranishme edhe shkurre dhe bimë si kaça, murrizi, mana, manaferra, etj.

Sa i përket faunës, bazuar në kushtet klimatike të rajonit, karakteristikat e florës ekzistuese, si dhe informacionet e siguruar nga banorët lokalë, rezulton se në këtë zonë janë të pranishëm lloje të ndryshme të faunës si: gjitarë të vegjël (lepur i egër, dhelpër, iriq), si dhe një gamë e gjerë insektesh. Ndër shpezët më të zakonshme janë bilbilat, thëllëza e fushës, sorrat dhe shqiponja.

Është e rëndësishme të theksohet se lokacioni në të cilin aktualisht operon impianti ndodhet në një zonë që tashmë ka qenë e ndikuar më parë nga ndërhyrjet njerëzore, përfshirë objektet për banim dhe aktivitetet e banorëve lokalë. Kjo tregon se ndikimi mjedisor i impiantit zhvillohet në një kontekst të një ambienti të transformuar dhe jo të paprekur, gjë që ul ndjeshmërinë ekologjike të zonës.

3.8 Ndërtimi gjeologjik i lokacionit

Rrethina e gjerë e lokacionit ku është duke u zhvilluar kjo veprimtari është e ndertuar nga këto formacione gjeologjike:

- Depozitimet e Neogjenit (Ng)
- Depozitimet e Kuaternarit(Q)

3.8.1 Depozitimet e Neogjenit

Sedimentet e miocenit janë të zbuluara në rrethinën e gjere të Pejës. Mioceni është i përfaqësuar prej konglomerateve kokërrtrashe, ranoreve me thjerrza zhavori, mergeleve dhe gelqeroreve. Trashësia e tyre lëvizet rreth 400m.

Shtrirje me të madhe në Basenin e Dukagjinit kanë sedimentet e ujërave të embla të pliocenit. Gjate hulumtimeve të realizuara në Basenin e Dukagjinit për zbulimin e shtresave të

thengjillit, me shpime të thella, është konstatuar trashësia e këtyre sedimenteve e cila sillet rreth 1000m.

Sedimentet e pilocenit janë të përfaqsuara me konglomerate, ranore dhe argjila me ndershtresa të thengjillit.

3.8.2. Depozitimet e Kuaternarit

Në Ultesirën e Dukagjinit, depozitimet e kuaternarit kanë një përhapje të madhe dhe karakterizohen me përberje të ndryshme gjenetike dhe litologjike. Depozitimet e kuaternarit janë të formuara gjatë: Pleistocenit dhe Holocenit.

Sedimentet e Pleistocenit – janë depozituara në të dy anët e Lumbardhit të Pejës. Terracat lumore shtrihen në të dy anët e lumenjeve të Ultesirës së Dukagjinit, e në veçanti të Lumbardhit të Pejës. Këto terraca paraqesin fundin e vjetër të rrjedhjes së këtyre lumenjeve. Përgjatë rrjedhës së këtyre lumenjeve (Lumbardhit të Pejës) dallohen dy terraca me moshe të ndryshme. Këto terraca janë depozitime të shtratit të lumenjeve.

Të dy terracat janë eroziv-akumulative dhe janë të mbuluara me ranore, argjila e zhavorë me trashësi 1 deri 7m. Këto sedimente janë të ndryshme dhe varen nga përberja e terrenit përmes të cilit kalon rrjedha e Lumbardhit të Pejës.

Duke u mbështetur nga sa më lartë u përmend, mund të potencohet se materiali i terracave të Lumbardhit të Pejës përbehet nga coprat e rrepsheve, gëlqeroreve, graniteve, diabazave, kuarcit dhe konglomerateve kuarcore.

Depozitimet e Holocenit janë krijime kontinentale të përbera nga tipe të facijëve të ndryshme gjenetike si: morena, proluvione, deluvione dhe aluvione. Aluvionet shtrihen përgjatë rrjedhjes së Lumbardhit të Pejës dhe të lumenjeve të tjera. Këto depozitime përfaqësohen prej rërës dhe zhavorit.

3.9. Karakteristikat sizmike

Sizmikja mikro-regjionale e këtij lokacioni dallohet me mundësi të dridhjeve të tokës të intensitetit prej 6-7 shkallë të Merkalit. Sipas hartave sizmike të regjionit, hapësira e gjerë e hulumtuar nuk i përket një intensiteti të njëjtë të dridhjeve sepse varet nga karakteristikat gjeologjike të tokës, ujërave nëntokësore, etj.

3.10. Efektet vizuale (peizazhi)

Karakteristikat e peizazhit të tërësisë së analizuar hapësinore paraqesin njërin nga elementet për të përceptuar marrëdhëniet e tërësishme në relacionin e impiantit në fjalë mjedisi.

Me këtë rast gjithësesi duhet marrë parasysh se bëhet fjalë për një kategori psikologjike afektive e cila manifestohet përmes veprimit të tërësishëm sinergjik të rrethinës në shikuesin, ku medoemos janë të pranishme implikimet kulturologjike, sociologjike dhe subjektive.

Efektet vizuale (peizazhet) janë kriteriume me rëndësi në ruajtjen e mjedisit dhe nëse nuk zgjidhen drejt konsiderohen si degradim i mjedisit.

3.11. Ajri

Në territorin e komunës së Istogut deri tani nuk janë bërë matje mbi shkallën e ndotjes së ajrit, ujit, tokës dhe zhurmës në mënyrë që të bëhet një vlerësim sa më preciz i gjendjes mjedisore për lokacionin ku gjendet ky biznes.

Nga vet konfiguracioni i terrenit dhe prezenca e florës, dhe mos ekzistimit të objekteve industriale në këtë lokacion, si dhe mos funksionimit të ish objekteve industrial në Istog, mund të konkludojmë se pastërtia e ajrit në këtë regjion është në nivel të lakmueshëm.

3.12. Uji

Kualiteti i ujit është i nivelit të ulët edhe pse ngastra ku është ndërtuar ky biznes dhe nuk ka ndotës potencial. Ndotja e ujit shkaktohet nga ujërat e zeza të cilat shkarkohen nga komuniteti në lumë të pa trajtuara, nga hedhja e mbeturinave nga komuniteti në brigjet e lumenjve dhe në shtretërit e tyre. Ndotja e ujërave vjen edhe nga aktivitetet ilegale të eksploatimit dhe seperimit të rërës dhe zhavorrit që ekzistojnë në këtë lokalitet.

3.13. Zhurma

Në lokacionin e analizuar dhe më gjerë nuk kemi ndonjë matje të zhurmës. Në afërsi të lokacionit ekzistojnë objekte industrial dhe banuse që gjeneron zhurmë dhe automjeteve që qarkullojnë nëpër rrugën e fshtit dhe rruget lokale që lidhin këto fshatra.

Mund të konstatojmë se në lokacionin ku është duke operuar ky biznes nuk kemi zhurmë të përherëshme që do të ndikonte në psikikën dhe koncentrimin njeriut në rrethinë.

3.14. Natyra dhe biodiversiteti

Monumentet Natyrore –Përgjatë territorit të komunës së Istogut gjenden lokacione që përmbajnë një ose më shumë monumente natyrore me veçori specifike dhe vlera unike– rariteti,

veçori natyrore, vlera rekreative ose estetike dhe vlera të posaçme kulturore. Mbrojtja e natyrës duhet të jetë e inicuar dhe të zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë me Agjencionin për Mbrojtjen e Mjedisit në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Llojet e ndryshme të monumenteve natyrore duhet të trajtohen me metoda të ndryshme të mbrojtjes. Janë tri lloje të monumenteve natyrore në komunën e Istogut të mbrojtura sipas Ligjit për Konservimin e Natyrës, neni 20, të cilat bazohen në veçoritë e tyre:

- ✓ Hidrologjike
- ✓ Botanike Monumentet natyrore me veçori hidrologjike janë të rëndësishë së veçantë për zhvillim në komunën e Istogut.

Në listën e monumenteve natyrore të mbrojtura me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, në komunën e Istogut janë tri burime:

- ✓ Burimi i ujit natyral në Istog
- ✓ Burimi i ujit natyral në Vrellë
- ✓ Burimi i ujit termomineral në Banjë

Zonat e mbrojtura këtu, pos vendit të burimit ujor përfshijnë edhe vendndodhjen dhe sipërfaqen rreth burimit (pika 2, neni 3, nr. 40 – 13/07 Udhëzimi Administrativ- Kriteret për përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Ujore dhe masat e tyre mbrojtëse për burimet e ujit që përdoren për pije). Burimet e ujërave termomineral në Banjë hyjnë në zonën e parë të mbrojtjes (neni 4, nr. 40 – 13/07 Udhëzimi Administrativ- Kriteret për përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Ujore dhe masat e tyre mbrojtëse për burimet e ujit që përdoren për pije). Kjo zonë e mbrojtjes i takon regjimit të rreptë, që përfshin mbrojtjen e drejtpërdrejtë rreth burimit të ujit dhe objekteve me instalime për marrjen e ujit si dhe mbrojtjen e burimit nga shkarkimet e ndotësve që mund të vijnë nga aktivitetet e njeriut. Shfrytëzimi, veprimi dhe mbrojtja në këto zona duhet të jenë në pajtim me nenet 21, 22, 23, 24 dhe 25 të këtij udhëzuesi. Duhet theksuar që ky burim i ujit është prone e kompanis (ne momentin e privatizimit të gjendres rekreative dhe Hotelit me objektet për rreth ka blere edhe burimin e ujit). Ndërsa parcelat ku planifikohet të ndërtohet impianti nuk është zone e mbrojtjes.

Duke u bazuar në bazë të dhënave zyrtare të Institutit për mbrojtjen e Natyrës dhe planit zhvellimore të komunës së Istogut nuk ekzistojnë të dhëna se në lokacionin ku do të ndërtohet impianti ka ndonjë zone të mbrojtur.

4. PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE INFRASTRUKTURA

4.1. Objektivat dhe infrastruktura

Kompania “Sylë Shala B.I.”, e regjistruar si biznes individual me aktivitet të specializuar në therjen e gjedheve, operon në këtë fushë që nga viti 2011. Brenda kësaj periudhe, kompania ka zhvilluar një infrastrukturë funksionale të përshtatur sipas kërkesave të veprimtarisë dhe standardeve përkatëse të sektorit. Aktiviteti kryesor zhvillohet në një kompleks të ndërtuar enkas për këtë qëllim, i cili përbëhet nga një sërë njësisish funksionale dhe hapësirash teknike të organizuara si më poshtë:

1. **Hapësira për therjen e gjedheve** – e pajisur dhe e përshtatur për kryerjen e procesit të therjes në mënyrë higjienike dhe efikase, në përputhje me kërkesat veterinare dhe të sigurisë ushqimore;
2. **Zona për vendosjen e mbeturinave të kafshëve** – e dedikuar për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve organike të krijuara gjatë procesit të therjes;
3. **Hapësira për organet abdominale** – ndarje specifike për përpunimin, inspektimin dhe magazinimin e përkohshëm të organeve të brendshme;
4. **Dhoma e mbajtjes** – ambient i mbyllur për strehimin e kafshëve para therjes, që respekton mirëqenien e kafshëve dhe standardet veterinare;
5. **Korridori i transportit të kafshëve** – strukturë ndërlidhëse për lëvizjen e sigurt dhe të kontrolluar të gjedheve drejt zonës së therjes;
6. **Zona për kriposje** – e destinuar për përpunimin dhe ruajtjen me kripë të mishit ose produkteve të tjera që kërkojnë trajtim të tillë.

Të gjitha objektet dhe hapësirat funksionale të sipërcekura janë ndërtuar duke përdorur një kombinim të konstruksionit prej çeliku dhe konstruksionit të betonit të armuar, i cili siguron stabilitet, qëndrueshmëri dhe mbajtje të ngarkesave të nevojshme për operimin normal të impiantit. Dimensionet dhe kapacitetet mbajtëse të strukturave janë të projektuara në përputhje me nevojat operative të aktivitetit dhe normat teknike ndërtimore.



Figure 5. Objekti ku zhvillohet aktiviteti I therrëtorës.

4.2. Procesi teknologjik i therjes se gjedheve per nevoja te restorantit

Mishi është një produkt shumë i rëndësishëm në dietën e njeriut për shkak të përbërjes së tij. Ai është një burim i rëndësishëm proteinash dhe lëndësh minerale kryesisht hekur (Fe). Duke qenë se është i pasur me lende ushqyese si, proteina, yndyra, minerale etj, ai është edhe një produkt tepër i preferuar për mikroorganizmat të cilat ndikojnë në konservimin e tij, duke e prishur këtë të fundit apo ajo që është akoma më keq duke e shndërruar në një produkt toksik për shëndetin e njeriut.

Dihet qe mishi ka një përmbajtje te larte uji që shkon deri në 60% dhe kjo favorizon zhvillimin e mikroorganizmave. Gjithashtu mishi ka një mjedis lehtësisht acid deri në 5.5 pas glikolizës, dhe një temperature rreth 37 grade pas therjes që është gjithashtu një mjedis ideal për zhvillimin e mikroorganizmave.

Parimi procesit to konservimit është inhibimi i proceseve mikrobike, duke krijuar kushte të tilla te ambientit te zhvillimin e tyre, dhe si pasoj vonojnë cilat nuk lejojnë alterimin e produktit. Pra konservimi ka për qellim ruajtjen e produkteve ushqimore për një kohe sa me te gjate, gjë e cila vlen edhe mishit. Nëpërmjet konservimit veprimtaria e mikroorganizmave ne mish dhe produktet e tij reduktohet ndjeshëm.

Skema e procesit të punës gjatë përpunimit dhe konservimit të mishit




Figure 6. Skema e procesit teknologjik.

4.6. Procesi që zhvillohet në thertore

Procesi i therjes së gjedheve në këtë thertore është relativisht i thjeshtë dhe nuk përfshin përdorimin e teknologjive të rënda apo pajisjeve të sofistikuara industriale. Aktiviteti ndjek metoda të ngjashme me ato tradicionale të therjes, por tashmë i zbatuar në kushte më të kontrolluara dhe në ambiente që përmbushin standardet bashkëkohore të higjienës dhe sigurisë ushqimore. I gjithë procesi zhvillohet me pajisje të përshtatshme për këtë lloj veprimtarie, duke siguruar trajtim të drejtë të kafshëve dhe cilësi të pranueshme të produktit final.

4.6.1. Korridori i transportit të kafshëve dhe vendi për mbajtjen e kafshëve para therjes

Korridori i transportit dhe hapësira për mbajtjen e gjedheve para therjes përbëjnë një nga komponentët kyç të funksionimit të therrëtorës, me rëndësi të veçantë për mirëqenien e kafshëve, sigurinë e punëtorëve dhe efikasitetin e procesit të therjes. Kjo strukturë është projektuar dhe ndërtuar me kujdes të veçantë, në përputhje me standardet veterinare dhe udhëzimet për mirëqenien e kafshëve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Korridori shërben si një zonë tranzitore për lëvizjen e kontrolluar dhe të sigurt të kafshëve nga hapësira e pritjes ose mbajtjes deri te zona e therjes. Ai është i ndërtuar me materiale të qëndrueshme, zakonisht konstruksion metalik i kombinuar me elemente betoni, që sigurojnë stabilitet dhe jetëgjatësi në kushte intensive pune. Sipërfaqja e dyshemesë është e përshtatur për të minimizuar rrëshqitjet dhe dëmtimet e mundshme të kafshëve gjatë lëvizjes. Gjithashtu, muret anësore të korridorit janë të mjaftueshëm të larta për të parandaluar daljen apo frikësimin e kafshëve, dhe janë pa cepa të mprehtë apo struktura që mund të shkaktojnë lëndime.

Në fund të korridorit gjendet hapësira për mbajtjen e kafshëve para therjes, e njohur ndryshe edhe si “dhoma e pritjes”. Kjo zonë është e projektuar për të strehuar kafshët për një periudhë të shkurtër kohe, për t’i lejuar atyre të qetësohen pas transportit dhe para se të procedohet me therjen. Kjo jo vetëm që përmirëson cilësinë e mishit, por është edhe një praktikë e domosdoshme për të respektuar standardet e mirëqenies shtazore. Ambienti është i ajrosur mirë, me ndriçim të mjaftueshëm dhe me akses të lehtë për pastrim dhe dezinfektim.

Në tërësi, kjo strukturë ndërlidhëse përfaqëson një pjesë thelbësore të funksionimit të impiantit, duke garantuar që procesi të zhvillohet në mënyrë humane, të kontrolluar dhe sipas kërkesave ligjore dhe etike për trajtimin e kafshëve.



Figure 7. Vendi ku vendosen gjedhet para therjes.

Ne me lartë është paraqitur vendi ku vendosen gjedhet kur te vin ne thertore, para se te theren kontrollohen nga veterinari. Me pastaj vendosen ne vendin e ku behet therja e tyre, pas therjes fillon procesi i copëtimit dhe behet gati te futet ne furrat e tymosjes dhe ne dhomat e ftohjes qe janë për ruajtjen e mishit.

4.6.2. Hapësira për therjen e gjedheve

Hapësira e dedikuar për therjen e gjedheve është projektuar dhe ndërtuar në përputhje me standardet bashkëkohore të sigurisë ushqimore, higjienës dhe kërkesave veterinare. Kjo zonë përbën një nga komponentët kryesorë të funksionimit të thertores, pasi aty realizohet procesi qendror i aktivitetit – therja e kafshëve dhe përpunimi fillestar i trupit të tyre.

Struktura e kësaj hapësire është e ndarë në mënyrë funksionale, për të mundësuar një rrjedhë të qartë dhe logjike të procesit të therjes, duke filluar nga momenti i futjes së kafshës në zonën e therjes, deri në përfundimin e fazave fillestare të përpunimit të mishit. Ambienti është i

ndërtuar me material ndërtimor të përshtatshëm për industri ushqimore – zakonisht me dysheme të padepërtueshme, të pjerrët për drenazhim të ujërave, dhe mure të lëmuara që mund të pastrohen e dezinfektohen lehtësisht.

Hapësira është e pajisur me të gjitha elementet e domosdoshme për kryerjen e sigurt dhe efikase të procesit, si: pajisje për gjakosje, vegla për heqjen e lëkurës, sisteme për ngritjen dhe varjen e karkasave, si dhe lavamanë dhe pajisje ndihmëse për mirëmbajtje të pastërtisë gjatë gjithë kohës. Ventilimi natyror ose mekanik siguron qarkullimin e ajrit dhe evitim të aromave apo gazrave të dëmshëm.



Figure 8. Hapësira për therrjen e gjedheve.

Gjithashtu, hapësira është konceptuar që të lejojë qasje të lehtë për inspektorët veterinarë dhe punëtorët e trajnuar, duke respektuar normat e sigurisë dhe mbrojtjes në punë. Organizimi i punës në këtë ambient është i tillë që mundëson ndarjen e zonave të pastra dhe të ndotura për të parandaluar ndotjen e kryqëzuar dhe për të ruajtur integritetin dhe sigurinë e produktit përfundimtar.



Figure 9. Vendosja e gjedheve për therje.

4.6.3. Hapësira për organet abdominale

Hapësira për trajtimin e organeve abdominale është një njësi e veçantë brenda objektit të thertores, e cila shërben për përpunimin, inspektimin veterinar dhe ruajtjen e përkohshme të organeve të brendshme të gjedheve, menjëherë pas nxjerrjes së tyre nga trupi i kafshës pas therjes. Kjo hapësirë ka një funksion të rëndësishëm në zinxhirin e përpunimit të mishit, sidomos në garantimin e sigurisë ushqimore dhe gjurmueshmërisë së produktit.

Zona është projektuar në mënyrë që të mundësojë ndarjen e qartë të organeve të ngrënshme nga ato jo të ngrënshme, në përputhje me praktikën veterinare dhe rregulloret për mbrojtjen e shëndetit publik. DysHEMEJA e kësaj hapësire është prej materiali të papërshkueshëm nga uji dhe e pjerrët për të mundësuar kullimin, ndërsa muret janë të veshura me material të lehtë për pastrim dhe dezinfektim.

Gjithashtu, kjo hapësirë është e pajisur me tavolina inoks për përpunimin e organeve, lavamanë për pastrim të menjëhershëm, si dhe kontenierë të mbyllur për ruajtjen e përkohshme të mbetjeve. Pajisjet dhe ambienti lejojnë që inspektori veterinar të kryejë kontrollin vizual dhe fizik të organeve për të vlerësuar gjendjen shëndetësore të kafshës dhe për të përcaktuar nëse mishi është i përshtatshëm për konsum njerëzor.

Ruajtja e përkohshme e organeve kryhet në temperatura të kontrolluara, kur është e nevojshme, për të shmangur dekompozimin dhe kontaminimin. Më pas, organet që përmbushin kriteret për konsum i nënshtrohen fazave të mëtejme të përpunimit ose shpërndarjes, ndërsa ato që nuk janë të përshtatshme dërgohen për asgjësim në mënyrë të sigurt dhe të dokumentuar.

Në tërësi, kjo hapësirë është e konceptuar për të përmbushur funksione të shumta – teknike, higjienike dhe veterinare – duke qenë një pikë kritike për sigurinë ushqimore dhe përmbushjen e standardeve ligjore në sektorin e përpunimit të mishit.



Figure 10. Hapësira për organet abdominale.

4.6.4. Burimi i gjedheve dhe kapaciteti aktual i therjes

Gjedhët që përpunohen në këtë thertore sigurohen kryesisht nga tregu vendor, por sipas nevojës dhe kushteve të tregut, kompania mund të furnizohet edhe nga tregjet e jashtme, duke marrë parasysh faktorët ekonomikë dhe çmimin e kafshëve në periudha të caktuara. Zgjedhja e

furnizuesve bëhet në mënyrë fleksibile dhe pragmatike, me qëllim sigurimin e lëndës së parë cilësore, në përputhje me kërkesat e konsumatorëve dhe kapacitetet e përpunimit.

Aktualisht, për shkak të kërkesës së kufizuar në treg dhe orientimit të kompanisë drejt një operimi më të qëndrueshëm ekonomik, aktiviteti zhvillohet në një shkallë minimale të prodhimit. Në kushte normale, në këtë thertore theren mesatarisht katër (4) gjedhe në muaj. Ky numër mund të ndryshojë varësisht nga rrethanat dhe sezonaliteti.

Në raste të veçanta, si gjatë festave apo në periudha me rritje të kërkesës, si p.sh. kur ka rritje të vizitorëve apo të porosive nga klientët, numri i therjeve mund të arrijë deri në gjashtë (6) gjedhe në muaj. Kjo tregon se kapaciteti i kompanisë ka potencial për rritje të përkohshme të prodhimit, në përputhje me kërkesën e tregut.

Megjithëse aktiviteti është në nivel minimal, kompania ruan një strukturë funksionale dhe operon në përputhje me të gjitha kërkesat ligjore dhe standardet veterinare, duke qenë e gatshme të zgjerojë prodhimin nëse krijohen kushtet e duhura tregtare dhe operative.

5. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS

Investimi në ndërtimin dhe funksionalizimin e thertoresh nga z. Sylë Shala, me qëllim plotësimin e nevojave të veta operationale, paraqet një kontribut të rëndësishëm në sektorin e prodhimit të mishit dhe ofrimit të produkteve ushqimore vendore. Ky projekt përfaqëson një qasje të qëndrueshme në përpunimin e mishit, duke synuar ruajtjen e standardeve të cilësisë dhe sigurisë ushqimore.

Megjithatë, është e pashmangshme që çdo ndërhyrje apo aktivitet i karakterit antropogjen të shkaktojë një nivel të caktuar ndikimi në mjedis. Këto ndikime ndryshojnë në intensitet, varësisht nga natyra e aktivitetit dhe masat e kontrollit të aplikuar. Në rastin konkret, pritet që ndikimet mjedisore të jenë të kufizuara dhe të menaxhueshme, duke filluar nga minimumi real i ndikimit e deri në shkallë të pranueshme sipas legjislacionit në fuqi.

Bazuar në një analizë të detajuar të kushteve ekzistuese në terren dhe të projektit ideor të prezantuar në këtë raport, është përgatitur një vlerësim i hollësishëm i ndikimeve të mundshme në mjedis. Kjo analizë përfshin gjithashtu edhe masat zbutëse dhe parandaluese që do të ndërmerren me qëllim minimizimin apo eliminimin e ndikimeve negative që mund të shfaqen gjatë ndërtimit dhe funksionimit të impiantit.

Analiza e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është ndërtuar në përputhje me gjendjen reale të lokacionit dhe specifikat teknike të impiantit për përpunimin dhe konservimin e mishit. Qëllimi kryesor i kësaj analize është të sigurojë një zhvillim të qëndrueshëm të aktivitetit, pa cenuar komponentët kryesorë mjedisorë, përfshirë:

- **Aspektet kimiko-fizike**, si ndikimi në burimet natyrore dhe ndryshimet në strukturën fizike të mjedisit;
- **Aspektet biologjike dhe ekologjike**, përfshirë ruajtjen e biodiversitetit dhe ndikimin në jetën e gjallë dhe biosferën;
- **Aspektet socio-ekonomike**, përfshirë ndikimet e mundshme pozitive apo negative, të përkohshme apo afatgjata, në komunitetin lokal dhe në zhvillimin ekonomik të zonës.

5.1. Ndikimet në ajër

Duke u bazuar në pozicionin gjeografik të thertoresh, e cila ndodhet në periferi të qytetit të Istogut (në pjesën jugore), nuk pritet të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e ajrit në zonat

e banuara. Aktiviteti nuk përfshin procese teknologjike që gjenerojnë emetime të dëmshme në ajër.

Megjithatë, ndikime të mundshme mund të paraqiten nëse nuk menaxhohen siç duhet mbetjet organike të gjedheve, të cilat, në rast të ekspozimit në ambient të hapur, mund të shkaktojnë erëra të pakëndshme dhe ndotje lokale të ajrit. Këto ndikime janë të menaxhueshme përmes masave të duhura higjienike dhe trajtimit të mbetjeve.

5.2. Ndikimet në tokë

Aktivitetet që do të zhvillohen në këtë impiant nuk pritet të shkaktojnë ndikime të konsiderueshme në tokë, përveç ndërhyrjeve që tashmë janë realizuar gjatë ndërtimit të objektit. Këto ndikime janë të lokalizuara brenda parcelës së kompanisë dhe nuk shtrihen përtej kufijve të saj.

Edhe pse toka në zonë klasifikohet si tokë e klasës së tretë të cilësisë, jashtë zonës së ndërtimit nuk do të ketë asnjë ndikim, pasi aktiviteti nuk përfshin operacione që ushtrojnë presion të drejtpërdrejtë mbi mjedisin tokësor.

Ujërat e ndotura që dalin nga procesi i therjes nuk do të ndikojnë në ndotjen e tokës, pasi impianti është i lidhur me sistemin e kanalizimit të fshatit. Për më tepër, kompania ka ndërtuar një gropë septike për trajtimin e ujërave të ndotura, duke ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar derdhjen në tokë apo ndotjen e mjedisit përreth.

Gjithashtu, nuk parashihen aktivitete që mund të shkaktojnë derdhje të substancave të rrezikshme si vajra apo kimikate të tjera, andaj rreziku për kontaminim të tokës mbetet minimal. për trajtimin e ujërave të ndotur. Ndërsa ndikime tjera si derdhje e vajrave etj, nuk ka.

5.3. Ndikimet në ujë

Në afërsi të lokacionit ku ndodhet thertorja nuk ka prani të rrjedhave apo grumbullimeve të ujërave sipërfaqësore që mund të ndikohen drejtpërdrejt nga aktiviteti i impiantit. Në anën e majtë të lumit Burim ndodhet një distancë mbi 300 metra larg nga objekti i thertoresh, duke siguruar një largësi të mjaftueshme për të parandaluar ndikimet e drejtpërdrejta.

Gjatë funksionimit të impiantit, cilësia e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore mund të ndikohen nëse menaxhimi i mëposhtëm nuk realizohet si duhet:

- Menaxhimi i papërshtatshëm i ujërave të zeza, i cili mund të çojë në depërtimin e ndotësve në ujërat nëntokësore;
- Menaxhimi jo i duhur i gjakut të gjedheve, i cili mund të shkarkohet në rrjedhat ujore më të afërta dhe të shkaktojë ndotje lokale.

Për këtë arsye, është e nevojshme të merren masa të posaçme për trajtimin dhe kontrollin e ujërave të ndotura para se ato të lirohen në ambient, në mënyrë që të shmangen ndikimet negative në mjedis.

5.4. Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë

Në këto zona të rajonit të Istogut rriten llojet me të zakonshme të florës dhe faunës. Në këtë zonë rriten dhe zhvillohen llojet e mbrojtura të florës dhe faunës. Zona përreth ku është duke ushtruar aktivitetin Sylë Shala, është zonë e banuar nga banoret, andej nuk do të ketë ndonjë ndikim të madh në florën dhe faunën. Gjithashtu, në këtë lokacion e as në zonën më gjerë deri më tani nuk është evidentuar ndonjë habitat i veçantë i llojeve të botës bimore apo shtazore. Edhe pse ky aktivitet nuk paraqet ndonjë rrezik specifik në florë dhe faunë.

5.5. Ndikimet në vendbanime dhe popullatë

Hapësira ku gjendet thertorja e lartpërmendur nuk ka ndikim negativ në popullatën e zonës, pasi që nuk ka pasur nevojë të zhvendoset ndonjë shtëpi, nuk do të bëjë ndonjë trysni gjatë operimit të sajë dhe nuk krijon shqetësim për banorët lokal. Në të kundërtën ka ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik të zonës dhe ndihmon në mbështetje përmes punësimit të komunitetit lokal, njëkohësisht sjell produkte të sigurta të mishit për banoret e Istogut dhe të Kosovës në përgjithësi.

5.6. Ndikimet nga zhurma

Si rezultat i natyrës së veprimtarisë së ushtruar në këtë fabrikë nuk pritet të ketë ndonjë ndikim në ngritjen e nivelit të zhurmës për mjedisin për rreth, e cila do të shqetësonte banorët e kësaj zone.

Thertorja punon vetëm gjatë atyre ditëve që ka therje të gjedheve, prandaj kjo është edhe e favorshme për fabrikën në lidhje me zhurmën, pasi në këtë orar qytetarët janë aktiv thuhet se të gjithë dhe zhurma është edhe me pak e ndjeshme.

5.7. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore

Aksidentet e mundshme që mund të ndodhin gjatë aktiviteteve, vlerësohen si raste të izoluar. Nuk ka aktivitet me materie të rrezikshme të cilat paraqesin potencial të lartë për rrezikimin e shëndetit të njeriut apo mjedisit në përgjithësi.

6. MASAT E MBROJTJES SË MJEDISIT

6.1. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër

Për të minimizuar ndotjen e ajrit nga aktiviteti i therjes, është e domosdoshme që operatori të kryejë mirëmbajtjen dhe lagjen e vazhdueshme të sipërfaqes së tokës në zonën e punës, për të parandaluar krijimin e pluhurit. Po ashtu, duhet të kushtohet vëmendje e veçantë mirëmbajtjes së pajisjeve mekanike dhe mjeteve të transportit, në mënyrë që të mos lirojnë gazra ndotëse në ambient. Këto mjete duhet të përdoren me kujdes dhe të mos mbahen të ndezura pa nevojë për të reduktuar emetimet e panevojshme.

Duke pasur parasysh natyrën e procesit të therjes, ndotja e ajrit pritet të jetë minimale. Megjithatë, gjatë funksionimit të impiantit do të merren masa shtesë, si:

- Mirëmbajtja e rregullt dhe pastrimi i hapësirës së impiantit;
- Kontrolli dhe mirëmbajtja periodike e makinerisë së punës dhe mjeteve motorike;
- Menaxhimi i kujdesshëm i mbetjeve organike, ku kompania ka lidhur marrëveshje me kompaninë rajonale të pastrimit për trajtimin dhe largimin e tyre në mënyrë të rregullt dhe të sigurt, duke shmangur ndotjen e ajrit nga mbetjet e gjedheve.

Këto masa do të sigurojnë që ndikimet në cilësinë e ajrit të mbeten në nivele minimale gjatë gjithë kohëzgjatjes së aktivitetit.

6.2. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë dhe në tokë

Në dobi të minimizimit të ndikimeve në tokë, siç është cekur edhe me lart nga ky aktivitet nuk pritet të ketë ndikime në tokë. Pjesa më e madhe e sipërfaqes së parcelës ku operon impianti për përpunimin dhe konservimin e mishit është e zone e gjelbëruar dhe pjesa tjetër ku ka lëvizje motorike është e shtruar me Asfalt.

Ndotja e ujit mund të vijë nga larja e pajisjeve që përdoren në therjen e gjedheve dhe gjaku i tyre, mirëpo fabrika në fjalë këto ujëra nga procesi i larjes i grumbullon dhe i dërgon në basenet (impiant) të ndërtuara nga përfaqësuesit e kompanisë në fjalë.

Me pastaj impianti për përpunimin dhe konservimin e mishit, ujerat pas të grumbullohen në gropën septike merren nga kompania e pastrimit të cilën e ka kontraktuar.

Për minimizimin e ndikimeve do të ndërmerren masat si në vijim:

- Ujërat që shkarkohen nga impiant, grumbullohen në grope septike, pastaj shkarkohen në rrjetin e kanalizimit.
- Masa e rëndësishme për zvogëlim do të jetë edhe grumbullimi dhe trajtimi i ujerave nga reshjet atmosferike si dhe mbledhjen e ujerave të shkarkuar nga të gjitha objektet dhe dërgimi i tyre në impiant për trajtim.
- Gjithashtu me qëllim të evitimit të ndikimeve tjera në ujëra, investitori duhet dhe do të zbatojë në përpikëri të gjitha ligjet dhe udhëzimet administrative për mbrojtjen e ujerave sipërfaqësore, ujerave nëntokësore dhe burimeve tjera të ujit.




Figure 11. Gropa septike për trajtim primar.

6.3. Masat për mbrojtje nga zhurma

Impianti për therje gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij nuk shkakton zhurmë ose një zhurmë të vogël e cila është brenda kufijve të lejuar. Parcela ku ushtron aktivitetin e tij impianti për përpunimin dhe konservimin e mishit, është afër rrugës së fshatit Gorazhdec, prandaj zhurma që krijohet është thuajse me e vogël se ajo e komunikacionit, si rrjedhojë e saj zhurma nuk paraqet ndonjë shqetësim të madh.

Megjithatë operatori duhet të marrë të gjitha masat e parapara sipas ligjit dhe akteve nën ligjore për parandalimin dhe zvogëlimin e zhurmës në kuadër të normave të lejuara, duhet të kontrollohen vazhdimisht pajisjet dhe impiantet të cilat prodhojnë zhurmën edhe për këtë ndikim duhet të shkurtohet në maksimum koha e mbajtjes ndezur të motorëve të mjeteve motorike, duke mirëmbajtur dhe duhet kushtuar rendësi e veçante të gjitha pajisjeve të cilat emitojnë zhurmë gjatë procesit të punës.

6.4. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë

Parcela në lokacionin në të cilën ushtron aktivitetin e vet, siç është cekur edhe më lart është mjaft e përshtatshme për këtë veprimtari ngase gjenden afër rrugës së fshatit dhe është në zonën e vendbanimeve, prandaj dhe nuk pritet ndikim negativ shtesë në peizazh, florë dhe faunë e lokacionit në fjalë dhe regjionit në përgjithësi.

6.5. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë

Në afërsi të zonës së ku është e ndërtuar dhe duke ushtruar aktivitetin e saj thertorja në Zallc. Afër fabrikës ka edhe shtëpi banimi mirëpo, të njëjtit nuk kanë pasur deri më tani ndonjë ankese rrethë aktivitetit.

Investitori ka bashkëpunim të ngushtë me komunitetin lokal të zone dhe do njoftojë ata me kohë për të gjitha aktivitetet e mundshme që mund të ndikojnë në vendbanim dhe në popullatën lokale gjatë këtyre aktivitetit.

6.6. Masat për mbrojtje nga rreziqet dhe aksidentet mjedisore

Aksidentet e mundshme që mund të ndodhin gjatë aktivitetëve të kësaj, mund të vlerësohen si raste të izoluara. Për të mos ardhur deri të ndonjë aksidenti eventuale investitori duhet që të merren të gjitha masat adekuate paraprakisht. Rreziku më i madh për ndonjë aksident vjen nga energjia elektrike si edhe pajisjet.

Komponentë mjedisore, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktojnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve:

Komponenti mjedisore	Potenciali për ndikim negativ	Veprimi që shkakton ndikimin	Masat që duhet të ndërmerren
Ajri	Ka potencial të vogla për ndotjen e kualitetit të ajrit.	Ajri ndikohet kryesisht gjatë erërave të forta të cilat mund të bartin pluhurin nga sipërfaqja e parcelës, si dhe nga ndikimi nga djegia e derivateve në makineria punuese dhe ato lëvizëse, lënda djegëse për ngrohje etj. Hedhja e mbetjeve të gjedheve në ambient. Dhe nga djegëja e drurit ahu.	Mirëmbajtje e sipërfaqeve të parcelës, Mirëmbajtja e makinerisë punuese, Mirëmbajtja e makinerisë lëvizëse dhe mos ndezja e motorëve të tyre pa nevojë, Përdorja e lëndës ngrohëse miqësore me ambientin etj. Trajtimi i tyre si pas ligjit për mbeturina dhe rregulloreve tjera. Në rast që ka tejkalime të shkarkimeve në ajër duhet të ndërmerren masat e nevojshme.
Uji dhe Toka	Në zonë nuk ka ujëra sipërfaqësore. Potencial për ndikimin ekziston të dheu dhe ujërat nëntokësore	Ndikimet mund të paraqiten si rezultat i keq menaxhimit të ujërave të shkarkuara nga procesi i përpunimit të mishit dhe pastrimit të pajisjeve që përdoren për prodhim.	Thertorja, e ka të ndërtuar impiantin për trajtimin e ujerave ndotura të shkarkuara nga procesi dhe me pas shkarkohen në kanalizimin e qytetit.
Natyra dhe biodiversiteti (flora dhe vegjetacioni, fauna, Zonat e mbrojtura të natyrës)	Potencial minimal, nuk ka zona të rrezikuara ose në zhdukje.	Sipërfaqja ku është ndërtuar impianti për therje është sipërfaqe e vogël, dhe kjo nuk mund të ndikojë në shkallën e mikrosistemi.	Me që në vendin e përtherje, është zonë urbane nuk ka florë dhe faunë shumë të zhvilluar dhe për rrethet në rajonin e Istogut në përgjithësi, rriten dhe zhvillohen llojet e ndryshme të florës dhe faunës. Mirëpo nuk ka të dhëna për ndonjë lloj të rrallë, apo të pazakonshëm të florës apo faunës, ndikimi është minimal,

			dhe pothuajse jo relevant.
Zhurma	Potencial minimal	Nga ky aktivitet për impianti për përpunimin dhe konservimin e mishit, ka potenciale te vogla te shkakimit te zhurmë	Mirëpo niveli i zhurmës nuk do të jetë i atillë që të ketë ndikim te madh në ambientin jashtëm.
Shëndeti i qytetareve dhe konsumatorëve	Potencial relativ	Në kushte jo të duhura mirëmbajtjes se hapësirës se impianti për përpunimin dhe konservimin e mishit dhe për rreth tij	Te gjitha pajisjet te cilat mund te kenë ndikime ne shëndetin e qytetareve do tu kushtohet rëndësi e veçan ne mirëmbajtjen e tyre.

7.7. Menaxhimi i mbeturinave

Gjatë operimit thertores, mbeturinat krijohen po thuajse se fare pake gjate procesit te punës. Mbeturinat te cilat mund te krijohen janë mbetjet e gjedheve dhe mbeturinat të cilat i bënë personeli gjatë procesit te punës.

Prandaj këto mbeturina duhet të adresohen në mënyrë adekuate, në mënyrë që ato mos të jenë faktorë ndotje në mjedis dhe të jenë në harmoni me praktikat e mira mjedisore dhe ligjet vendore në fuqi.

Për largimin e këtyre mbeturinave nga lokacioni Sylë Shala B.I. ka marrëveshje me kompaninë për menaxhimin e mbeturinave nga komuna e Istogit, përkatësisht me kompaninë.

Për mbetje e mundshme te këtij aktiviteti, zgjidhja është si ne vijim:

- Mbeturinat ditore nga personeli do të grumbullohen dhe do të adresohen në mënyrë adekuate në kontejnerët e ndërmarrjes komunale për mbeturina, ndërsa
- Mbeturinat e mbetjeve te gjedheve do te merren nga kompania qe është e kontraktuar për këtë.

7. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

7.1. Monitorimi

Duke u bazuar në situatën aktuale në terren dhe natyrën e aktivitetit të therjes së gjedheve, i cili nuk përfshin përdorimin e teknologjive të rënda apo proceseve që shkaktojnë trysni të madhe mjedisore, monitorimi i detyrueshëm dhe i vazhdueshëm i treguesve mjedisor konsiderohet i nevojshëm dhe i rëndësishëm.

Treguesit kryesorë mjedisor, si cilësia e ajrit, menaxhimi i ujërave të zeza dhe trajtimi i mbetjeve, do të monitorohen rregullisht për të siguruar që aktiviteti të mos shkaktojë ndotje apo dëme mjedisore. Në çdo rast, nëse identifikohen devijime apo rreziqe për mjedisin, do të merren menjëherë masat korrektuese në përputhje me legjislacionin përkatës dhe do të njoftohen organet kompetente. Kjo qasje garanton funksionimin e qëndrueshëm të impiantit, duke respektuar normat dhe standardet mjedisore dhe duke minimizuar ndikimet negative në ambient.

7.2. Raportimi

Raportimi i monitorimit mjedisor do të kryhet nga personi përgjegjës i autorizuar nga menaxhmenti i kompanisë, zakonisht ekspertë të specializuar në fushën e mjedisit. Ky proces është i domosdoshëm për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullative të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Mbrojtjen e Mjedisit dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.

Në kuadër të raportimit do të përfshihen të dhënat e detajuara për monitorimin e të gjitha parametrave mjedisorë të kërkuar në Pëlqimin Mjedisor dhe Lejen Mjedisore, të lëshuara nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI). Këto parametra mund të përfshijnë, ndër të tjera, cilësinë e ajrit, menaxhimin e ujërave të zeza, trajtimin e mbetjeve dhe ndotësve të tjerë potencialë.

Raportet do të përgatiten dhe dorëzohen periodikisht sipas afateve të përcaktuara në lejen mjedisore, duke përfshirë gjithashtu masat e ndërmarra për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis. Në rast se gjatë monitorimit identifikohen shkelje ose rreziqe për mjedisin, kompanisë i kërkohet të ndërmarrë menjëherë masa korrigjuese dhe të raportojë organet kompetente përkatëse.

Ky sistem raportimi dhe monitorimi garanton transparencë, përgjegjësi dhe përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të veprimtarive dhe ruajtjen e ambientit për brezat e ardhshëm.

8. MASAT REHABILITUESE PAS PËRFUNDIMIT TË AKTIVITETIT

Pas përfundimit të aktivitetit prodhues në impiant, është e domosdoshme që të gjitha pajisjet dhe strukturat teknologjike të çmontohen plotësisht dhe të largohen nga lokacioni në mënyrë të sigurt dhe efikase. Bazamentet dhe platotë që kanë shërbyer për mbajtjen e këtyre strukturave duhet të shkatërrohen dhe të imtësohen në përputhje me standardet mjedisore dhe teknike, duke u përgatitur për largim në mënyrë të kontrolluar dhe të qëndrueshme. Materialet e mbetura dhe mbeturinat e këtyre operacioneve duhet të depozitohen në deponotë regjionale të autorizuar, në përputhje me rregulloret e menaxhimit të mbetjeve të Kosovës.

Struktura përfundimtare e terrenit duhet të jetë e riformuar dhe e mbuluar me dheun adekuat, që të jetë në harmoni me karakteristikat e dheut ekzistues dhe të përshtatet me substratin natyror të tokës në atë zonë. Ky proces synon të rigjenerojë strukturën dhe cilësinë e tokës, duke krijuar një bazë të shëndetshme për zhvillime të ardhshme të qëndrueshme.

Rikultivimi i sipërfaqeve të dëmtuara ose të degraduara për shkak të ndryshimit të destinimit të tokës është një pjesë thelbësore e procesit të rehabilitimit mjedisor. Ky proces përfshin rivitalizimin dhe restaurimin e plotë të hapësirës së prekur nga aktivitetet e mëparshme, me qëllim rikthimin e funksioneve ekologjike dhe ekonomike të tokës në mënyrë sa më natyrale dhe efikase.

Zgjedhja e modelit të rikultivimit do të bazohet në qëllimin e përdorimit të ardhshëm të tokës, i cili do të përcaktohet nga planet zhvillimore komunale dhe udhëzimet mjedisore përkatëse. Ky proces përfshin vlerësimin e kushteve të terrenit, karakteristikave klimatike dhe ekosistemit lokal për të siguruar që rikultivimi të jetë i qëndrueshëm dhe të kontribuojë në ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit jetësor për komunitetin lokal dhe brezat e ardhshëm.

9. KONKLUZIONE

Pas analizës së studimit të kryer për identifikimin e ndikimeve të mundshme mjedisore dhe masave për parandalimin e tyre, si dhe bazuar në intervistat, opinionet dhe dokumentacionin ekzistues, mund të përfundojmë me këto konkluzione:

- **Thertorja Sylë Shala B.I.**, e ndërtuar pas luftës në Kosovë dhe e cila ushtron aktivitetin e saj, paraqet një interes të rëndësishëm:
 - ✓ Për vetë investitorin, duke i ofruar mundësinë për përmirësimin e kushteve të punës dhe për rritjen e sasive dhe cilësisë së produkteve të ofruara;
 - ✓ Për komunën, pasi kjo do të ndikojë pozitivisht në rritjen e punësimit dhe të ardhurave lokale;
 - ✓ Për banorët e zonës përreth, duke siguruar një ambient më të menaxhuar, mundësi punësimi dhe produkte ushqimore me cilësi të garantuar.
- Nëse thertorja operohet dhe mirëmbahen në mënyrë profesionale, duke respektuar standardet e kërkuara dhe masat e parashtruara në këtë raport, si dhe duke bashkëpunuar ngushtë me autoritetet përgjegjëse, aktiviteti konsiderohet i pranueshëm plotësisht, si nga aspekti mjedisor, ashtu edhe nga ai social dhe ekonomik.
- Duke marrë parasysh natyrën e aktivitetit, vendndodhjen, kapacitetin dhe intensitetin e operacioneve, mund të konkludohet se ndikimet në mjedisin lokal janë minimale dhe plotësisht të kontrollueshme.

Në bazë të këtyre të dhënave, konsiderojmë se raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) është i plotë dhe i mjaftueshëm, dhe i propozojmë institucioneve kompetente, në veçanti Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPHI), që të japin mendim pozitiv dhe të lëshojnë Pëlqimin Mjedisor në përputhje me kërkesën e investitorit-aplikuesit.

10. Literatura

1. Plani Zhvillimor Komunal i komunës së Istogut
2. Qavolli. R. (1997): Gjeografia regjionale e Kosovës. Prishtinë.
3. MMPH (2013): Legjislacioni mjedisor në Kosovë 2007-2013 (Vëllimi I). Prishtinë.
4. B. Shehu dhe K. Karaxha, Hidrologji Inxhinjerike, 1996, Tirane,
5. S. Daka, Furnizimi me ujë pastrimi i ujit, 2007 KGT Prishtinë,
6. S. Daka, Kanalizimi i Vendbanimeve, 2004 KGT Prishtinë,
7. K. Katundi, Furnizim me ujë dhe trajtimi i tyre, Tiranë,
8. MMPH-AKMM (2008): Raport i gjendjes së mjedisit 2006-2007. Prishtinë.
9. MMPH-AKMM -IKMN (2008): Raport i gjendjes së natyrës 2006-2007. Design House. Prishtinë.
10. MMPH-AMMK (2010): Gjendja a Natyrës-Raport 2008-2009. UNDP. IN Design. Prishtinë.
11. MMPH-IHMK – Buletini Hidro-Klimatologjik 2016,
12. MMPH_IHMK – Resurset Ujore te Kosves 2015,
13. MMPH-IHMK – Vjetari Hidrometerologjik 2014,
14. mmph-rks.org/Ligjet
15. Osmani, J. (2008): Vendbanimet e Kosovës.